

Termt e Referencës

Lehtësues për identifikimin dhe referimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK), Bashkia Kavajë

Projekti: ‘Vlerëso-Fuqizo-Vepro: stafe sociale më të fuqizuara përballë shërbimeve të kujdesit social, për fëmijët me AK, në Bashkinë Kavajë’

Kohëzgjatja: 56 ditë pune për periudhën 15 shkurt 2024 - 30 gusht 2024. Ditët e përcaktuara do të dakordësohen me menaxherin e projektit.

Vendi ku do të veprojnë lehtësuesit: Kavajë, Shqipëri.

Konteksti

Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes po zbaton projektin ‘Vlerëso-Fuqizo-Vepro: stafe sociale më të fuqizuara përballë shërbimeve të kujdesit social, për fëmijët me AK, në Bashkinë Kavajë’, në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata shpall thirrjen për të bashkëpunuar me 2 (dy) lehtësues që do të ndihmojnë në identifikimin e fëmijëve me AK në qytetin e Kavajës.

Përshkrim i projektit

Projekti “Vlerëso-Fuqizo-Vepro: Stafe sociale më të fuqizuara përballë shërbimeve të kujdesit social, për fëmijët me AK, në Bashkinë Kavajë” u hartua në përgjigje të nevojave të identifikuar për shërbime të kujdesit social për fëmijët me aftësi të kufizuara në bashkinë Kavajë. Vlerësime dhe studime të realizuara përmes projekteve të ndryshme tregojnë qartë se fëmijët me aftësi të kufizuara, përballen vazhdimisht me një sërë problemesh socio-ekonomike, rrjedhimisht në nevojë për shërbime të përkujdesit social. Bashkia e Kavajës ka ende nevojë për ndërhyrje në drejtim të rritjes së kapaciteteve të stafit social në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të standardizuara të kujdesit social, gjë që tashmë është një domosdoshmëri. Mungesa e mjeteve dhe materialeve që lidhen me fushat e zhvillimit për fëmijët me AK në qendrën ditore “Ngjyrat e Jetës” çënon të drejtën e tyre për të zhvilluar dhe përmirësuar zhvillimin e tyre intelektual. Sigurimi i mjeteve dhe materialeve didaktike i shërbejnë qendrës për të organizuar aktivitete të ndryshme në fushat e zhvillimit për fëmijët me AK.

Qëllimi i përgjithshëm: Qëllimi i projektit të propozuar është të sigurojë që fëmijët me AK në bashkinë Kavajë të përfitojnë nga përmirësimi i sistemit të shërbimeve të kujdesit social.

Objektivi specifik 1. Krijimi i një tabloje më të qartë të nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Kavajë.

Objektivi specifik 2. Forcimi i kapaciteteve të strukturave bashkiake për të krijuar dhe ofruar shërbime cilësore dhe të përshtatshme të kujdesit social bazuar në nevojat specifike të

Rezultati i pritshëm 1. Fëmijët me aftësi të kufizuara që jetojnë në Bashkinë Kavajë do të kenë mundësi të aksesojnë shërbimet e kujdesit social dhe do të marrin mbështetje të drejtpërdrejtë nga stafi i kujdesit social.

Rezultati i pritshëm 2. Kapacitetet teknike dhe praktike të stafit në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Kavajë dhe në qendrën ditore 'Ngjyrat e Jetës' në lidhje me planifikimin, buxhetimin, ofrimin dhe monitorimin janë përmirësuar dhe përshtatur sipas nevojave të evidentuara për fëmijët me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Kavajë.

Përshkrimi i angazhimit

Në kuadër të këtij projekti, një skuadër terreni e përbërë nga dy profesionistë të fushës sociale (lehtësues) do të identifikojnë rastet e fëmijëve me AK në nevojë në të gjithë territorin e Bashkisë Kavajë (qytet dhe njësi administrative) duke shkuar aty ku jetojnë fëmijët me AK, duke bërë një vlerësim të nevojave të tyre si dhe referimin e tyre në shërbime përkatëse bazuar në nevojat e identifikuar.

Të dy lehtësuesit do të punojnë së bashku në terren 7 ditë në muaj për një periudhë kohore prej 8 muajsh. Ata do të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me stafin social bashkisë, NjA-ve dhe Qendrës ditore si dhe aktorë të tjerë lokalë si qendra shëndetësore në këtë zonë apo staf i organizatave jo – fitimprurëse që ofrojnë shërbime për fëmijët me AK në bashkinë Kavajë. Për çdo rast të identifikuar, lehtësuesit do të dorëzojnë raporte individuale për çdo fëmijë. (50 fëmijë në total ose edhe më shumë në varësi të rasteve të evidentuara), raportet do të jenë një format i njëjtë gjatë gjithë periudhës së identifikimit, do të jetë i hartuar edhe i miratuar bazuar nevojave për vlerësimin e një fëmije me AK dhe gjithashtu do të dorëzojnë raporte mujore për punën e tyre në terren ndaj organizatës ACFD.

Shërbimi i kërkuar/Produktet:

Do të angazhohen 2 (dy) lehtësues/e, të cilët do të punojnë (shtatë) ditë në muaj për një periudhë 8 (tetë) mujore. Secili prej tyre do të angazhohet për 56 (pesëdhjetë e gjashtë) ditë në total.

- Identifikimi i rasteve të fëmijëve me AK dhe problematikat që shoqërojnë këtë grup fëmijësh,



QENDRA SHQIPTARE
PËR ZHVILLIMIN E FAMILJES

- Zhvillimi i takimeve në vendet ku jetojnë këta fëmijë,
- Kryerja e një vlerësimi të nevojave,
- Referimi i tyre në shërbimet e duhura bazuar në nevojat e identifikuara.

1 raport mujor nga secili prej lehtësuesve për punën e realizuar që do të dorëzohen me email periodikisht në fund të çdo muaji dhe raporti i fundit deri më 30 gusht 2024, në adresën infoacfdalbania@gmail.com . Raporti duhet të bazohet gjithmonë në objektivat dhe treguesit përkatës dhe të fokusohet në arritjen e rezultatit.

Kriteret, kualifikimet dhe eksperiencia

Lehtësuesi/ja 1

- Bachelor: Punë Sociale;
- Master Shkencor: Administrim Shërbimesh Sociale; Të jetë i trajnuar për Metodën ABA;
- Trajnim mbi Sjelljet Problem (Problematika në sjellje, ndikimi në zhvillimin gjuhësor, dhe në metodat e menaxhimit)
- Trajnim mbi testin e koeficientit të zhvillimit mendor;
- Eksperiencë pune 4 vjeçare në fushën e shërbimeve sociale.

Lehtësuesi/ja 2

- Bachelor: psikologji -sociologji;
- Master profesional: psikologji shkollore dhe zhvillimore;
- Trajnimi i metodës ABA;
- Trajnim mbi testin e koeficientit të zhvillimit mendor;
- I/E trajnuar në Inteligjencën emocionale;
- Ekperiencë pune 2 vite në fushën e Psikologji-Sociologjisë

Përzgjedhja e kandidatëve

Perzgjedhja do të bazohet mbi:

- Përputhjen e aplikimit me kërkesat e vendosura në ToR
- Eksperiencën e aplikantit/es
- Ofertën financiare më të ulët;

Vetëm eksperti/ja i/e përzgjedhur do të kontaktohet nga “Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes.

Mënyra e aplikimit:



- CV dhe letër motivimi;
- Oferta financiare ku të përfshihen edhe detyrimet ligjore financiare;
- Numrin e llogarisë personale;
- Aplikimi duhet të paraqitet në gjuhën shqip;
- Vërtetim QKB (në rast se disponohet).

Dorëzimi i dokumentave do të bëhet nëpërmjet email-it në adresën e organizatës infoacfdalbania@gmail.com, në adresën postare Rr. Loni Ligori, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap.10, Tiranë, brenda datës 12/02/2024 ose **Nuk pranohen ofertat dorazi**.

Lutem sigurohuni që subjekti i aplikimit (në zarf ose në email) të përfshijë titullin e thirrjes për të cilën aplikon “Aplikim - **Lehtësues për identifikimin dhe referimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK), Bashkia Kavajë**”.

Mënyra e pagesës:

- Pagesa e individëve kryhet me transfertë bankare pas nënshkrimit të kontratës dhe dorëzimit të produkteve të përcaktuara më sipër.
- Për lehtësuesit/et dhe shërbimin që ata do japin do të paguhet tatimi në burim pranë organeve tatimore (në rast se aplikanti nuk është i pajisur me NIPT).